ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: MINISTRIA E INFRASTRUKTURES

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**205-23-1843-5-1-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **"Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9-Segmenti Kijevë-Dollc,Loti 1,2,3,4."**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

R & Rukolli SH.P.K. dhe SABA BELCA DOO Dega në Kosovë dhe ELMAZAJ KONSTRUKSION SH.P.K. dhe Tekno-Konstrukt SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Skenderaj; Obiliq; Tiranë; Skenderaj
(Adresa)

Skenderaj — ***41 000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

+383 (0) 49309213
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Ragip Behrami
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

r.rukolli@hotmail.com
(Adresa elektronike)

01.07.2024

(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

_____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 Njoftim per Kontrat publikuar ne e-prokurim me datë 08.03.2023 ora 15:02
B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve publikuar ne e-prokurim me datë 04.05.2023 ora 14:29
B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK-107 publikuar ne e-prokurim me datë 08.02.2024
08.03.2023 Njoftim për kontratë,
17.03.2023 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara,
13.04.2023 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara,
24.04.2023 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara,
24.04.2023 Publikimi i dosjes së tenderit të korrigjuar,
04.05.2023 ora 14:00 Afati i fundit i dorëzimi i tenderëve,
04.05.2023 Proces verbali i hapjes se Tenderve
29.12.2023 Vendimi i AK dhe letrat standarde për tenderuesit ku jemi shpallur fitues per Lot 1,
03.01.2024 Vendim për pezullim,
03.01.2024 Janë dorëzuar kërkesat për Rishqyrtim,
09.01.2024 Vendim mbi kërkesën për Rishqyrtim.
11.01.2024, 15.01.2024, 18.01.2024 dhe 19.01.2024 janë dorëzuar ankesat ne OSHP nga 6 OE
21.02.2024 Raporti i ekspertit shqyrtues
19.03.2024 Vendimi i Panelit Shqyrtues te OSHP-se
11.06.2024 B58 Njoftim mbi vendim. Raporti i vleresimit

11.06.2024 Kërkesë për qasje në dokumentacion (1) 12.06.2024 10:49 B47 Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit (Info bllokimin e qasjeve me USB) 12.06.2024 13:24 B47 Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit (Njoftim per qasje ne dokumenta - peja 1) 12.06.2024 Kërkesë për qasje në dokumentacion (2) 13.06.2024 15:06 B47 Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit (Info 2 bllokimin e qasjeve me USB) 14.06.2024 11:59 B47 Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit (Njoftim per qasje ne dokumenta) 18.06.2024 Kërkesë për qasje në dokumentacion (3 18.06.2024 Kërkesa për rishqyrtim 21.06.2024 Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale
Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me 11.06.2024 kemi pranuar Letër standarde për *tenderuesin* e eliminuar, ku na janë cekur disa arsye subjektive dhe te pa pranueshme për eliminimin e ofertës tone.

Duke ju referuar dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate këto arsye nuk qëndrojnë sepse ne kemi plotësuar ne tërësi kushtet dhe kriteret e kërkuara, ndërsa OE i rekomanduar nuk i plotëson kushtet e kërkuara dhe është i papërgjegjshëm me ç'rast AK-MMPHI ka shkelur në tërësi Ligjin e prokurimit Publik kur ka shpallur fitues një OE të papërgjegjshëm për arsyet te cilat do t'i paraqesim më poshtë e po ashtu sipas analizimit dhe krahasimit te ofertës tonë dhe OE te rekomanduar gjithsesi oferta jonë arrin më shumë poena në bazë te poentimit në bazë te 19. KRITERET E PROPOZUARA PËR DHËNIEN E KONTRATËS në dosje te tenderit.

Arsyet e eliminimit te ofertës tonë sipas AK-MMPHI janë:

Duke u bazuar në Vendim të OSHP-së: 2024/0048 me nr. PSH. Nr. 0048/24; 0050/24; 0056/24; 0057/24; 0058/24; 0059/24 te datës 19.03.2024 oferta e juaj pas ankesave të rekomandimit të parë, pretendimet ankimore janë cilësuar si pjesërisht të bazuara. Lidhur me të gjitha këto pretendime Eksperti shqyrtues i ka pasqyruar në detaje në raportin e ekspertizës i cili është i njohur për palët në procedurë dhe duke ju përgjigjur me arsyetime të cilat gjejnë bazë në dispozita ligjore dhe të cilat i mbështet edhe Paneli Shqyrtues duke i kualifikuar këto pretendimet ankimore si pjesërisht të bazuara andaj oferta juaj eliminohet si e pa përgjegjshme në këto pika.

GOE nuk e plotëson kërkesën 7 të dosjes së tenderit lidhur me licencën për prodhimin e bazës se asfaltit sepse i njëjti ka prezantuar Licencën pa afat .

Nuk e plotëson kërkesën 5 të DT se përvoja e inxhinierit të komunikacionit nuk korrespondon me kërkesën e dosjes së tenderit që në këtë rast është ndërtimi, rehabilitimi, apo rikonstruktimi i rrugëve, dhe duke u bazuar ne LPP nuk mund te kërkohet sqarim me nenin 72 sepse e njëjta ka prezantuar te dhënat e njëjta ne CV dhe te dhënat e njëjta në Referenca duke mos lenë hapësirë për kërkesa për sqarim.

Nuk e plotëson kërkesën 8 të kapacitetit teknik dhe profesional të njoftimit për kontratë dhe dosje te tenderit. GOE i kanë dorëzuar dokumentin e Planit të Menaxhimit te trafikut te pa vulosur si dhe:

1. **Në asnjërën nga skemat e paraqitura të planit të menaxhimit të trafikut nuk është paraqitur sinjalistika horizontale e përkohshme (vija e plotë e verdhë) për punime me zgjatje më të madhe se 7 ditë e cila është e domosdoshme për informimin e pjesëmarrëseve në trafik për zonën e punimeve.**
2. **Në skemën e paraqitur për bllokimin e rrugës (Rasti I) është paraqitur sinjalizimi me kona të trafikut të cilat bazuar në standardet e projektimit përdoren për punime jo më të gjata se dy ditë.**
3. **Skemat e paraqitura për punime në rrugë (skema 1a dhe skema në vazhdim) vërejmë se projektimi I planit të menaxhimit të trafikut nuk është projektuar bazuar në situacionin ekzistues dhe janë të huazuara janë shume të paqarta shenjat vertikale të përdorura në vend-punishte.**

Sipas skicave të ofruara në Planin e menaxhimit të trafikut mund të konstatojmë se nuk është marrë për bazë qëllimi i këtij plani i cili është :
Plani I menaxhimit të trafikut me skica të detajuara është I domosdoshëm më qëllim të afrimit të sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në trafik përgjatë gjithë kohës së zhvillimit të punimeve.

Kërkesën 10 të DT- Listën e pajisjeve Grejder 12-16t - 3 cope. Eksperti sqaron se nga 6 pajisjet – Grejder të paraqitur në listën e pajisjeve nga GOE i rekomanduar për kontratë për Lot 1, sipas dëshmive të dorëzuara për pajisjen me numër 1rendor 1 (O&K tipi F156 viti 1999) nuk ka paraqitur të dhëna për peshën si dhe nuk ka dorëzuar dëshminë – Dokumentin Unik Doganore. Për pajisjen me numër rendor 2 (O&K tipi F156 viti 1994) ka peshën në intervalin 12-16 T. Pajisja me numër rendor 3 (Volvo G 726 B) ka peshën 20.000.00 kg. Pajisja me numër rendor 4 (O&K, Tipi: F 105) ka peshën 10.000.00 kg, dhe pajisja me numër rendor 5 (Cat 140 M) ka peshën 23,583 kg. Si përfundim, eksperti sqaron AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së se në raport me vlerësimin për pajisjet. **Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar në këtë pikë.**

Dhe duke u bazuar ne përgjigjjen e ekspertizës të datës 21.02.2024 dhe ne vendim te OSHP: 2024/0048 me nr. PSH. Nr. 0048/24; 0050/24; 0056/24; 0057/24; 0058/24; 0059/24 te datës 19.03.2024
"Lidhur me të gjitha këto pretendime Eksperti shqyrtues i ka pasqyruar në detaje në raportin e ekspertizës i cili është i njohur për palët në procedurë dhe duke ju përgjigjur me arsyetime të cilat gjejnë bazë në dispozita ligjore dhe të cilat i mbështet edhe Paneli Shqyrtues duke i kualifikuar këto pretendimet ankimore si pjesërisht të bazuara." oferta juaj është e pa përgjegjshme.

Lidhur me pretendimin e komisionit vlerësues:

GOE nuk e plotëson kërkesën 7 të dosjes së tenderit lidhur me licencën për prodhimin e bazës se asfaltit sepse i njëjti ka prezantuar Licencën pa afat .

Eksperti Shqyrtues e ka sqaruar ne Ekspertizen e tij ne faqe 164 se OE ka dorëzuar licencën për gurthyes me afat deri me datë 18.04.2023, që i bie të ketë pasur vlefshmëri në kohën e publikimit për kontratë. Ndërsa po ashtu në dosjen tonë ne kemi paraqitur edhe formularin për vazhdimin e licencës si dhe dëshminë e pagesës, prandaj ne si grup i OE-ve jemi i përgjegjshëm plotësisht, ndërsa vendimi për vazhdim te licencës behet nga organi përgjegjës KPMM, por këtu vlenë te theksohet se KPMM i ka lejuar qe te funksionojne te gjitha bazat dhe gurthyesit te cilëve ju ka skaduar licenca deri sa te merr një vendim për vazhdimin e tyre, kështu qe AK-MMPHI nuk ka asnjë arsye te marrjës së vendimeve te kundërligjshme sa i përket rastit tonë.
Pavarësisht këtij fakti, në procedurat e tenderimit kërkesat e dosjes së tenderit duhet të përmbushen për tu konsideruar një tender i përgjegjshëm, prandaj në këtë rast ne e plotësojmë këtë kërkesë.

Komisioni vlerësues është munduar që të ndërlidh mendimet e ekspertit shqyrtues në lidhje me ofertën tonë por kur vjen në shprehje sqarimi qe ka dhënë në lidhje me validitetin e licencës nga ana e po këtij eksperti shqyrtues, atëherë komisioni nuk e përmend sqarimin e ekspertit e qe kjo dëshmon se ky komision ka bërë vlerësim subjektiv, te gabuar profesionalisht, tendencioz dhe shkelje te neneve te LPP-se te cekura më lartë.

Në dosje të tenderit tek pika 9.1&9.2 është kërkuar në këtë mënyrë:
7. OE duhet te jete i licencuar leje per aktivitete te veqanta për prodhimin e bazës se asfaltit, prodhimin e bazës se betonit dhe OE duhet te jete i licencuar si gurëthyes zhavorr
Dëshmia 7- Kopja e licences lejesper aktivitete te veqanta të vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale.
Vëmendje!
Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE. Marreveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit.

Duke pasur parasysh këtë kërkesë dhe dëshmi dokumentare, vërehet se ne e plotësojmë këtë kërkesë plotësisht.
Në dosje të tenderit s'ka qenë e përcaktuar që nëse licenca skadon gjate vlerësimit të tenderëve eliminohen kompanit ofertuese, prandaj përderisa s'ka qen një kërkesë e tille atëherë AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 t LPP-s ku shkruan;

Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Nga kjo dispozitë kuptohet se asnjë kompani nuk mund të eliminohet nga konkurrenca nëse nuk ka ofruar ndonjë dëshmi që nuk është kërkuar në dosje të tenderit.
Prandaj kërkojmë nga eksperti shqyrtues që të sqaron në detaje këtë fakt dhe ti rekomandoj AK, se duhet ti merr parasysh të gjitha dëshmitë dhe kërkesat dosjes së tenderit e jo ti merr pjesërisht.

Lidhur me pretendimin e komisionit vlerësues:

Nuk e plotëson kërkesën 5 të DT se përvoja e inxhinierit të komunikacionit nuk korrespondon me kërkesën e dosjes së tenderit që në këtë rast është ndërtimi, rehabilitimi, apo rikonstruktimi i rrugëve, dhe duke u bazuar ne LPP nuk mund te kërkohet sqarim me nenin 72 sepse e njëjta ka prezantuar te dhënat e njëjta ne CV dhe te dhënat e njëjta në Referenca duke mos lenë hapësirë për kërkesa për sqarim.

Ky është një pretendim plotësisht me tendenca dhe i rrejshëm për tu munduar që të paraqiten disi ndryshe përvoja dhe referencat e inxhinieres së komunikacionit me te cilën kemi lidhur kontratë mbi vepër për këtë projekt pasi qe te gjitha punët e paraqitura në CV dhe referenca kanë te bëjnë me punë te sinjalizimit në projektet te ndërtimit, rehabilitimit apo rikonstruktimit te rrugëve, madje inxh. i komunikacionit në fjalë përveç qe ka një përvojë shumëvjeçare në shumë projektet nga te gjitha fushat e sinjalizimit dhe komunikacionit (siç dëshmohet në CV dhe referenca) e njëjta është edhe asistente - eksperte e komunikacionit gjygjesore e angazhuar nga Gjykata e Suharekes dhe Prizrenit në mbi 200 raste te ndryshme te komunikacionit e qe kjo paraqet një nivel shumë te avancuar profesional.

Sa i përket kësaj arsye të eliminimit dhe arsyes tjetër me radhë, sqarojmë se anëtarët e komisionit vlerësues nuk kanë kompetencë profesionale për të bërë vlerësim të këtyre dëshmive. Komisioni vlerësues i përbërë nga Flora Pajaziti ing ndërtimtarisë, Afërdita Shkoreti (zyrtare e prokurimit) dhe Hysejn Doberçani ing. ndërtimtarisë pra asnjëri nuk janë inxhinier i komunikacionit që do te thotë se nuk kanë kompetencë profesionale për vlerësim nga fusha e komunikacionit e po ashtu te njëjtit veprojnë ën mënyrë tendencioze dhe duke keqpërdor autorizimet e tyre, sepse nuk shfrytëzojnë nenin

59.2 dhe nenin 72 të LPP, për të kërkuar sqarime shtesë, por japin arsyetime të pa bazuara, madje mund ti quajmë edhe të rrejshme.
Edhe për këtë arsye të eliminimit, kërkojmë nga OSHP që të analizohen në detaje dëshmitë tonë dhe me rastin e rekomandimi dhe të vendimmarrjes të kenë parasysh nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe Nenin 10 Të Udhëzuesit Nr.001/2023 Për prokurim Publik.

Edhe në lidhje me pretendimin e komisionit vlerësues

Kërkesën 10 të DT- Listën e pajisjeve Grejder 12-16t - 3 cope. Eksperti sqaron se nga 6 pajisjet – Grejder të paraqitur në listën e pajisjeve nga GOE i rekomanduar për kontratë për Lot 1, sipas dëshmive të dorëzuara për pajisjen me numër 1rendor 1 (O&K tipi F156 viti 1999) nuk ka paraqitur të dhëna për peshën si dhe nuk ka dorëzuar dëshminë – Dokumentin Unik Doganore. Për pajisjen me numër rendor 2 (O&K tipi F156 viti 1994) ka peshën në intervalin 12-16 T. Pajisja me numër rendor 3 (Volvo G 726 B) ka peshën 20.000.00 kg. Pajisja me numër rendor 4 (O&K, Tipi: F 105) ka peshën 10.000.00 kg, dhe pajisja me numër rendor 5 (Cat 140 M) ka peshën 23,583 kg. Si përfundim, eksperti sqaron AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së se në raport me vlerësimin për pajisjet. **Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar në këtë pikë.**

Komisioni vlerësues ka përdor standarde të dyfishta gjatë vlerësimit dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së përkitazi me nenin 7 të LPP-së, sepse nuk na është drejtuar me kërkesë për sqarime, ndërsa standard tjetër ka përdor në raport me OE SALLAHU, ku nga ai ka kërkuar sqarime lidhur me grejderat ndërsa neve si grup i OE-ve nuk na ka kërkuar sqarime edhe pse një gjë e tillë është paraqitur si gjetje edhe nga eksperti shqyrtues, por prap komisioni vlerësues mundohet qe shkeljen e vet ta arsyetoj përmes mendimit te eksperti shqyrtues duke e paraqitur si bazë ndërsa në fakt po ky ekspert shqyrtues ka evidentuar shkeljen e nenit 59 te cilën shkelje prap e bënë komisioni vlerësues në mënyrë selektive.

Komisioni vlerësues ka interpretuar pjesërisht mendimet e ekspertit shqyrtues dhe ekspertizën e ka përdor vetëm në ndonjë pjesë kur i ka konvenuar atyre, kurse konstatimet tjera nuk i ka marr parasysh.
Sqarimi lidhur me grejderët e ofruar nga ana jonë:

1. Përshkrimi: Greder (Rrafshues) TIPI: O&K F156, Kapaciteti: 15.8 T, viti i prodhimit: 1999, Ngjyra: e Kuqe. Është dorëzuar fatura e shitblerjes nr. 45/2020 e lëshuar nga "Vëllëzrit Ramadani" e cila mbanë datën: 04.02.2021 me përshkrimin: Greder i përdorur Marka: O&K, Tipi: F156, Nr. serisë 107359, Viti i prodhimit: 1999, "grederi asht me defekt trapi i parë", nr i DUD-it 9855/2020. **Në këtë rast kanë mundur të kërkohen sqarime, prandaj DUD-in në fjalë, të cilin është dashur që të kërkojë komisioni vlerësues, po ua dërgojmë bashkëngjisim me këtë ankesë.**
2. Përshkrimi: Greder (Rrafshues) TIPI: O&K F156, Kapaciteti: 15.8 T, viti i prodhimit: 1994, Ngjyra: e Kuqe. Është dorëzuar fatura e shitblerjes nr. 45/2020 e lëshuar nga NP"EURO BAG" e cila mbanë datën: 23.11.2020 me përshkrimin: Greder i përdorur Marka: O&K, Tipi: F156, Ngjyra e kuqe, Viti i prodhimit: 1994, Shenja&nr: 106559. Poashtu është dorëzuar Dokumenti Unik Doganor me numër të referencës doganore 28550, datë 23.11.2020 ku paraqitën të dhënat e pajisjes: GREDER O&K tipi F156, Viti i prodhirnt-1994, Nr serik 106569 dhe peshë 15.800.00 kg (neto dhe bruto).
   Pra ky grejder është pranuar edhe nga komisioni vlerësues.
3. Po ashtu kemi dorëzuar dokumentacionin në pronësi te OE-ve te grupit për 4 grejder tjerë me peshë afërsisht me atë të kërkuar për te dëshmuar kapacitetet teknike te grupit te OE-ve.
   Pavarësisht këtyre fakteve, ne e kemi plotësuar kërkesën për pajisjet e kërkuara për Grejder. Kërkojmë nga OSHP-ja që të merren parasysh këto dëshmi, e po ashtu kërkojmë që të detyrohet autoriteti kontraktues që të shfrytëzojë në mënyrë të drejtë nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe që këto dispozita ti përdor dhe shfrytëzojë në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë ofertuesve e jo në mënyrë selektive sikurse në këtë rast, ku ka rezultuar me shklje të nenit 7 të LPP.

Neve kemi kërkuar qaje në dokumentet e grupit të shpallur fitues, mirëpo qasja na është dhënë në mënyrë shumë të kufizuar dhe me këtë rast kemi shkelje të nenit 10 të LPP-së dhe natyrisht edhe të nenit 11, sepse për tu konsideruar sekret afarist dokumentet duhet dhënë arsyeshmëri sipas nenit 11.3 të LPP. Tek grupi i OE të shpërblyer me kontratë nuk shihet ndonjë arsyeshmëri e dhënë se përse të gjitha dokumentet janë sekret afarist dhe nuk është dhënë ndonjë shpjegim se si mund ët dëmtohet materialisht ky grup nëse zbulohen këto dëshmi-të dhëna.
Në vijim po paraqesim gjetjet të OE tjerë nga dokumentacioni i pakët qe na është dhënë nga zyra e prokurimit e AK-MMPHI gjatë qasjes.

Gjetjet tek grupi i OE-ve "*GRANIT Shpk dhe K.N.P.SH. PAPENBURG&ADRIANI COMPANY SH.P.K*."
Ky grup i OE-ve nuk e ka plotësuar kërkesën 11.1 te FTD "Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik" pasi qe në Deklaratën e Grupit te OE-ve nuk e kanë përfshi paragrafin d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të **jenë të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.

Gjatë qasjes në dokumentacion, përkatësisht me CD na janë dhënë vetëm lista e kontratave e te dy OE-ve, ku nga to shihet se OE-të në këto lista i kanë paraqitur edhe kontrata jo siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.
Kërkesa e dosjes së tenderit në lidhje me kontratat dhe referencat ka qenë si në vijim:

Lista e kontratave te realizuara perfunduara ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare nga data e njoftimit per kontrate.Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve duke deshmuar me Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve ne lëmine e kërkuar per periudhën e shkuar tre vjeçare

Sipas kësaj kërkese, gjatë vlerësimit duhet te merren parasysh vetëm kontratat e realizuara përfunduara ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar 3 vjeçare nga data e njoftimit për kontratë, e projekteve në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruimit te rrugëve duke dëshmuar me procesverbale te pranimit teknik përfundimtar te punëve. Ndërsa në listat e dorëzuara nga OE-të "*GRANIT Shpk dhe K.N.P.SH. PAPENBURG&ADRIANI COMPANY SH.P.K.*" shihet se kanë paraqitur edhe kontrata te cilat **nuk kanë përfunduar akoma** si dhe kontrata te mirëmbajtjes.
Kontrata që janë të papërfunduara nuk duhet të merren parasysh sepse janë në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit, e po ashtu edhe kontratat e mirëmbajtjes janë në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit, prandaj këto dëshmi nuk janë sipas kërkesës së Dosjen së Tenderit, pra qe i bie se vlera totale e kontratave te realizuara në periudhën e shkuar 3 vjeçare nga data e njoftimit për kontratë nga OE Graniti Shpk (sipas listës edhe pse neve nuk na janë prezantuar këto kontrata dhe as procesverbalet e pranimeve teknike përfundimtare te punëve) është 1,410,898.14 Euro, ndërsa vlera totale e kontratave te realizuara në periudhën e shkuar 3 vjeçare nga data e njoftimit për kontratë nga OE K.N.P.SH. PAPENBURG&ADRIANI COMPANY SH.P.K. (sipas listës edhe pse neve nuk na janë prezantuar këto kontrata dhe as procesverbalet e pranimeve teknike përfundimtare te punëve) është 5,305,625.81 Euro, e që i bie se ky grup i OE-ve në total ka realizuar kontrata në vlerë 1,410,898.14 + 5,305,625.81 = 6,716,523.95 Euro. Edhe pse AK-MMPHI nuk na ka ofruar dëshmi për asnjërën nga këto kontrata gjë qe e bënë te dyshimtë vërtetësinë edhe të këtyre vlerave (sepse kemi pasur raste kur OE-të kanë marr referenca për projekte më datë të mëvonshme se sa data e pranimit teknik përfundimtar te punimeve dhe ne dyshojmë se edhe në këtë rast këta dy OE e kanë bërë te njëjtën gjë).
Kërkojmë nga eksperti shqyrtues që të analizon në detaje dëshmitë për punë të kryera duke përfshi referencat dhe dëshmitë e tjera, sepse neve nuk na është lejuar qasje po thuajse në ë tërë dokumentacionin e grupit të shpërblyer me kontratë.

Ndërsa vlera totale e kontratave te realizuara nga ana jonë në periudhën e shkuar 3 vjeçare nga data e njoftimit për kontratë është kështu:

1. OE R & Rukolli SH.P.K. është: 9,067,084.79 Euro
2. OE SABA BELCA është: 6,393,823.28 Euro
3. OE ELMAZAJ KONSTRUKSION është: 11,850,745.68 Euro

Pra vlera totale e kontratave te realizuara në periudhën e shkuar 3 vjeçare nga data e njoftimit për kontratë nga grupi jonë i OE-ve është: 9,067,084.79 + 6,393,823.28 + 11,850,745.68 = 27,311,653.75 Euro.

E nga kjo duhet te konkludohet se sipas tabelës së poentimit në 19. KRITERET E PROPOZUARA PËR DHËNIEN E KONTRATËS nga kriteri:

2	**Përvoja për punë të ngjashme**	Përvoja për punë të ngjashme në 3 vitet e fundit.	20	(pao/Pa)x20

Oferta e grupit tonë "*R & Rukolli SH.P.K. dhe SABA BELCA DOO Dega në Kosovë dhe ELMAZAJ KONSTRUKSION SH.P.K. dhe Tekno-Konstrukt SH.P.K.*" tek përvoja sipas nënkritereve të poentimit duhet te merr 20 poena, ndërsa oferta e grupit "*GRANIT Shpk dhe K.N.P.SH. PAPENBURG&ADRIANI COMPANY SH.P.K.*" duhet te merr (6,716,523.95 / 27,311,653.75) x 20 = 4.918 poena,
Pra këtu mund te shihet dallimi shumë i madh i poenave qe marrin dy grupet e OE-ve duke e krahasuar poentimin sipas Kategorisë 2 te 19. KRITERET E PROPOZUARA PËR DHËNIEN E KONTRATËS.

Në secilin variant të përdorur, ne jemi ofertues me tenderin ekonomikisht më të favorshëm, prandaj është dashur të shpallemi fitues i këtij tenderi.

Neve si grup i OE-ve nuk na është dhënë tabela e poentimit te OE-ve, e po ashtu komisioni vlerësues nuk e ka paraqitur këtë tabelë as në raportin e vlerësimit te cilin e kemi marr përmes e prokurimit me 11.06.2024 14:58, prandaj edhe ky fakt dëshmon se janë bërë shkelje te rënda te të gjitha dispozitave te LPP-së dhe kritereve te vlerësimit dhe kritereve te Dosjes së Tenderit, ku komisioni vlerësues është munduar që të favorizojë më çdo kusht një grup te OE-ve që në çdo aspekt ka dorëzuar ofertën e papërgjegjshme dhe më te pafavorshme.
Mbi këtë bazë dyshojmë se përse nuk është publikuar në E prokurim raporti i poentimti kur dihet se këto dokumente duhet të jenë publike dhe të qasshme për kompanitë ofertuese, madje edhe për palë të tjera që nuk janë ofertuese. Krejt kjo mbyllje e të dhënave është bërë me një qëllim, që të mos dalin në pah mangësitë e grupit të OE të shpërblyer me kontratë.

Sa i përket kriterit te poentimit te Kategorisë **1** ndryshimi në çmim ndërmjet dy grupeve te OE-ve nëse krahasohen del shumë i vogel, po ashtu neve na është pamundësuar madje edhe dhënia e listës së pajisjeve te grupit te OE-ve "*GRANIT Shpk dhe K.N.P.SH. PAPENBURG&ADRIANI COMPANY SH.P.K.*" por jemi te bindur qe edhe tek ky kriter ne kemi ofruar më shumë Pajisje dhe Mekanizim (pasi qe edhe i dimë kapacitete e grupit tjetër edhe nga qasjet e mëhershme në dokumentacion gjatë vitit 2023), e po ashtu edhe tek kriteri i poentimit sipas Kategorisë 4 – Plani dinamik ne kemi ofruar një plan dinamik shumë te detajuar, te punuar në mënyrë shumë profesionale me softuerin profesional MS Project si dhe kemi dhënë kohën optimale te shkurtë për të realizuar projektin në fjalë.
Pra, duhet të analizohet nga eksperti shqyrtues edhe mekanizmi dhe pajisjet e edhe plani dinamik i grupit të shpërblyer me kontratë se si janë ofruar.

Kur kem parasysh mos lejimin e qasjes në dokumentacion të grupit të OE të shpërblyer me kontratë kërkojmë nga eksperti i OSHP-së që të analizohen dokumentet e këtij grupi dhe të vërtetohet saktë se

sa poena mund ti merr ky grup duke pasur parasysh dëshmitë e ofruara nga i njëjti dhe dëshmitë e ofruara nga ne.
Por shkeljet nga AK-MMPHI me mos dhënien e qasjes në dokumentacion na e pamundësojnë edhe gjetjen e shkeljeve tjera te dispozitave te LPP-së si dhe mos përmbushës së kritereve tjera te Dosjes së Tenderit nga grupi i OE-ve "*GRANIT Shpk dhe K.N.P.SH. PAPENBURG&ADRIANI COMPANY SH.P.K.*", prandaj eksperti shqyrtues duhet analizuar edhe shkeljet e nenit 10 dhe 11 të LPP-së, e që në fund të konstatohen shkeljet e tilla dhe të detyrohet AK që të respektojë këto dispozita për të na lejuar qasje ën dokumentet e grupit të shpërblyer me kontratë.
Prandaj gjatë procesit të ankesës kërkojmë nga Zyrtarët Përgjegjës qe te krahasojnë me kujdes ofertat e dy grupeve te OE-ve dhe te vlerësoj drejtë duke bërë korrigjimet e duhura qe do te rezultojnë me dhënien e poentimeve reale sipas përmbushjës nga grupet e OE-ve me ç'rast edhe do te korigjohen gabimet e komisionit vlerësues si dhe do te respektohet Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.
Autoriteti kontraktues ka vazhduar me shkelje ligjore dhe me mosrespektim të dispozitave të LPP-së, konkretisht të nenit 109 të LPP me rastin e nxjerrjes së vendimit për refuzim ku nuk ka dhënë asnjë arsye se përse është refuzuar kërkesa për rishqyrtim por thjesht me një fjali e përmbyssh arsyetimin e vendimit.
Edhe nga ky fakt kuptohet qartë se autoriteti kontraktues është i ndikuar në vendim marrje dhe në vazhdimin e kësaj procedure me shkelje ligjore.

Nga dëshmitë që u cekën më lartë vijmë në përfundim se vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë sipas nenit 59 të LPP-së, e po ashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi ekonomikisht më i favorshëm.
Autoriteti kontraktues nuk ka respektu edhe nenin 59.2 dhe 72 të LPP, në mënyrë të drejtë dhe të barabartë por ka vepruar në mënyrë të njëanshme në raport me kompaninë tonë, prandaj duhet obliguar nga OSHP-ja që të respektohet këto dispozita të LPP.
Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse na ka diskriminuar neve duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe kemi ofruar tenderin ekonomikisht më të favorshëm.
Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente"*.
Po ashtu neni 7 par 6 i LPP-së e parasheh që *"Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse",* mirëpo AK nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse është rekomanduar për kontratë OE i papërgjegjshëm.
AK-ja është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e grupit të OE **R & Rukolli SH.P.K. dhe SABA BELCA DOO Dega në Kosovë dhe ELMAZAJ KONSTRUKSION SH.P.K. dhe Tekno-Konstrukt SH.P.K.** si e bazuar, **ANULOHET,** njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM, ndërsa obligohet** autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëme të konsiderueshme materiale te cilat përfshijnë shpenzimet për përgatitjen e tenderit, si dhe nga mos fitimi i kontratës në fjalë, qe në total llogaritet te jetë rreth 20% e vlerës së ofertës tonë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*